



Prishtinë, 8 qershor 2012

Nga: **Z. Enver Halimi**, Kryesues i Bordit

Për: **Z. Arben Gjukaj**, Drejtor Menaxhues, KEK sh.a  
**Z. Fadil Ismaili**, Drejtor Menaxhues, KOSTT sh.a

Kopje: **Z. Besim Beqaj**, Ministër i zhvillimit ekonomik  
**Z. Ismet Krasniqi**, Sekretaria e Parlamentit të Kosovës  
**Z. Zenun Pajaziti**, Kryesues i Komisionit për zhvillim ekonomik, tregti dhe industri  
**Z. Petrit Pepaj**, Drejtor për çështje Rregullative dhe tarifa, KEK sh.a  
**Znj. Resmije Ahma**, Drejtoreshë për çështje ligjore dhe rregullative, KOSTT sh.a  
**Znj. Fllanza Hoxha**, Menaxher i projektit për Projektin e privatizimit të KEDS-it

#### Lënda: Shqyrtimi i shtatë i tarifës (shumë-vjeçare) të energjisë elektrike (SHTE7)

Të nderuar,

Po ju drejtohem me qëllim të prezantimit të planeve të ZRRE-së për Shqyrtimin e shtatë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE7) i cili do të përcaktojë të hyrat e nevojshme për të licencuarit në një periudhë shumë-vjeçare të shqyrtimit, ashtu siç është përcaktuar me Rregullat për përcaktimin e çmimeve të lëshuara nga ZRRE-ja vitin e kaluar.

Me shpalljen e SHTE6 më 10 janar të këtij viti, ZRRE pati deklaruar se nuk e konsideron të mundshme të bëjë një shqyrtim të plotë periodik të të hyrave të lejuara për të licencuarit në prodhim pasi që, në përputhje me Rregullat e përcaktimit të çmimeve, shqyrtimi i tillë duhet të iniciohet të paktën 120 ditë pune para se të hyrat e reja të lejuara të hyjnë në fuqi. Rrjedhimisht, të hyrat për këta të licencuar do të përcaktohet gjatë këtij shqyrtimi të radhës.

Rregullat për përcaktimin e çmimeve e vënë datën minimale të inicimit të shqyrtimit shumë-vjeçar. ZRRE beson se, duke qenë se ky është proces i parë i këtij lloji, të gjitha palët do të kenë dobi në një periudhë më të gjatë kohore, duke ofruar kështu kohë për diskutime me të hollësishme direkte me të licencuarit jashtë periudhave formale të konsultimit publik. Krahas kësaj, orari indikativ është si në vijim:

- Inicimi i konsultimit mbi formularët e raportimit shumë-vjeçar – 11 qershor 2012
- Data përmblyëse për konsultime – 29 qershor 2012
- Formatet e raportimit iu lëshohen të licencuarve – 9 korrik 2012



- Afati i fundit për kthimin e formateve të përcjellura me parashtrës të shkruara – 31 gusht 2012
- Dëgjimet publike, ku të licencuarit do t'i prezantojnë parashtrimet e tyre ZRRE-së dhe publikut – 3 shtator 2012
- Vlerësimi kalimtar botohet për konsultime – 19 tetor 2012
- Data përmbyllëse për konsultime – 9 nëntor 2012
- Vlerësimi përfundimtar botohet për konsultim – 28 dhjetor 2012
- Data përfundimtare për konsultime – 18 janar 2013
- Dëgjimi publik – 11 shkurt 2013
- Vendimi përfundimtar mbi të hyrat maksimale të lejuara – 28 shkurt 2013
- Të licencuarit propozojnë tarifën dhe ngarkesat rezultuese për aprovim – 15 mars 2013
- Aprovimi i tarifave dhe ngarkesave – 29 mars 2013

Konsultimi fillestar do të ngrejë një sërë pyetjesh që duhet të shtjellohen si pjesë e rishikimit, dhe do të jep udhëzime lidhur me supozimet që do të bëhen me përfundimin e formularëve të raportimit. Veçanërisht, do të doja të theksojë këtu që ZRRE-ja ka parasysh se aktualisht Qeveria është duke zhvilluar procesin e shitjes së KEDS-it dhe se ky proces është në fazë kritike. ZRRE-ja beson se veprimi më i përshtatshëm është të vazhdohet me vëllimin e vet të punës si Rregullator të përcaktuar me Rregulloret dhe atë në një mënyrë të planifikuar dhe konsultative. ZRRE-ja do të konsiderojë përmbushjen e nevojave të arsyeshme të cilitdo ofertuesi të suksesshëm përkitazi me orarin për rishikimin e OSSH-së, FPEE-së dhe licencave tregtare përderisa kjo mund të bëhet pa cenuar të licencuarit e tjerë dhe funksionimin normal të sektorit.

Për çdo informacion shtesë, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.

Me respekt,

  
Enver Halimi  
Kryesuesi i Bordit

